VENDIM
Nr. 263, datë 2.5.2024

PËR AUTORIZIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, PËR NEGOCIMIN DHE NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT STRATEGJIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË *"ORACLE CORPORATION"*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "d", të nenit 31, të ligjit nr. 43/2023, "Për qeverisjen elektronike", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së partneritetit strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë *"Oracle Corporation"*.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku